

VENDIM
Nr. 1058, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “MBI EMRAT E FIBRAVE TEKSTILE DHE ETIKETIMI E MARKIMI PËRKATËS I PËRBËRJES SË FIBRAVE TË PRODUKTEVE TEKSTILE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”, sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULL TEKNIK

MBI EMRAT E FIBRAVE TEKSTILE DHE ETIKETIMI E MARKIMI PËRKATËS I PËRBËRJES SË FIBRAVE TË PRODUKTEVE TEKSTILE

KAPITULLI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Fusha e veprimit

Ky Rregull Teknik përcakton rregullat që kanë të bëjnë me:

- a) përdorimin e emrave të fibrave tekstile, si dhe etiketimin e markimin e lidhur me përbërjen e fibrave të produkteve tekstile;
- b) etiketimin ose markimin e produkteve tekstile që kanë në përbërjen e tyre pjesë jotekstile me origjinë shtazore; dhe
- c) përcaktimin e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile, sipas analizave sasiore të përzierjeve të fibrave tekstile dyshe dhe atyre treshe,

me qëllim përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm dhe për t’u dhënë konsumatorëve informacion të saktë.

2. Qëllimi

2.1 Ky Rregull Teknik zbatohet për produktet tekstile kur ato bëhen të disponueshëm në tregun shqiptar, përfshirë edhe produktet e referuara në nënpikën 2.2.

2.2 Për qëllimet e këtij Rregulli Teknik, produktet e mëposhtme trajtohen në të njëjtën mënyrë si produkte tekstile:

- a) produkte që përmbajnë fibra tekstile së paku në 80% të peshës së tyre;
- b) mbulesa të mobiljeve, çadrave dhe tendave të diellit që përmbajnë komponentë tekstile së paku në 80% të peshës së tyre;
- c) komponentë tekstile të:
 - i) shtresës së sipërme të mbulesave të dyshemesë me shumë shtresa;
 - ii) mbulesave të dyshekut;
 - iii) mbulesave të objekteve të kampingut,

me kusht që komponentët tekstilë të përbëjnë së paku 80%, të peshës së këtyre shtresave të sipërme ose mbulesave;

ç) tekstile të përfshira në produkte të tjera dhe që formojnë një pjesë integrale të tyre, kur përbërja e tyre është e specifikuar.

2.3 Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për produktet tekstile, të cilat iu kontraktohen perso-nave që punojnë në shtëpitë e tyre apo në firma / kompani të pavarura që punojnë me material porositës, pa transferim pronësie.

2.4 Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për produkte tekstili të bëra me porosi nga rrobaqepës të

vetëpunësuar.

3. Përkufizime

3.1 Për qëllimet e këtij Rregulli Teknik, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) produkt tekstili” është çdo produkt bruto i papunuar, gjysmë i punuar, i punuar, gjysmë i përpunuar, i përpunuar, i gatshëm apo gjysmë i gatshëm që përbëhet vetëm nga fibra tekstile, pavarësisht nga procesi që është përdorur për përzierjen apo mbledhjen e tij;

b) “fibra tekstile” kanë kuptimet e mëposhtme:

i) një njësi materiali/lënde që karakterizohet nga lakueshmëria (elasticiteti), hollësia dhe shkalla e larte e gjatësisë në përmasat maksimale tërthore, që e bëjnë të përshtatshëm për aplikime tekstile;

ii) një rrip/shirit ose tub i lakueshëm, gjerësia e dukshme e të cilit nuk i kalon 5mm, duke përfshirë rripa të prerë nga rripa apo shtresa më të gjera, të prodhuara nga substancat e përdorura për prodhimin e fibrave të listuara në tabelën 2 të pikës 19 dhe i përshtatshëm për aplikime tekstile;

c) “gjerësia e dukshme/e jashtme” është gjerësia e rripit apo tubit kur paloset, sheshohet, ngjishet, apo përdridhet/rrotullohet, ose gjerësia mesatare kur gjerësia nuk është uniforme;

ç) “komponent tekstili” është një pjesë e një produkti tekstili me përmbajtje të identifikueshme fibrash;

d) “fibra të huaja” janë fibrat përveç atyre të përcaktuara në etiketë ose në markim;

dh) “astar” është një komponent i ndarë që përdoret për bërjen e veshjeve dhe produkteve të tjera, i cili përbëhet nga një shtresë e vetme apo disa shtresa materiali tekstil që mbahen së bashku të bashkuara në njërin ose në disa anë;

e) “etiketim” është vendosja e informacionit që kërkohet në lidhje me produktin tekstil, nëpërmjet bashkëngjitjes së një etikete;

ë) “markim” është tregimi i informacionit të kërkuar direkt në produktin tekstil me anë të qepjes, qëndisjes, printimit, stampimit ose ndonjë teknologji tjetër aplikimi;

f) “etiketim gjithëpërfshirës” është përdorimi i një etikete të vetme për disa produkte apo komponentë tekstili;

g) “produkt me një përdorim” është një produkt tekstili, i projektuar për t’u përdorur vetëm një herë ose për një kohë të kufizuar dhe përdorimi i zakonshëm i të cilit nuk është parashikuar për përdorim të mëtejshëm për qëllim të njëjtë apo të ngjashëm;

gj) “tolerancë e lejueshme” është vlera e rifituar /rimarrë e lagështisë që do të përdoret në llogaritjen e përqindjes së komponentëve të fibrës mbi bazën e masës së pastër, të tharë, pas aplikimit të faktorëve tradicionalë të zakonshëm të faktorëve konvencionalë.

3.2. Për qëllimet e këtij Rregulli Teknik përkufizimet “bërje e disponueshme në treg”, “vendosje në treg”, “prodhues”, “importues”, “shpërndarës”, “operatorë ekonomikë”, “standardi harmonizuar”, “mbikëqyrje e tregut” dhe “autoritet i mbikëqyrjes së tregut” kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 10438, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

4. Kërkesa të përgjithshme për bërjen të disponueshme në treg të produkteve tekstile

Produktet tekstile bëhen të disponueshme në treg vetëm kur këto produkte janë të etiketuara, të markuara ose të shoqëruara me dokumente tregtare në përputhje me këtë Rregull Teknik.

KAPITULLI 2

EMRAT E FIBRAVE TEKSTILE DHE KËRKESAT PËRKATËSE PËR ETIKETIMIN DHE MARKIMIN E TYRE

5. Emrat e fibrave tekstile

5.1 Vetëm emrat e fibrave tekstile, të përcaktuar në pikën 19, përdoren për përshkrimin e përbërjes së fibrave në etiketat dhe markimet e produkteve tekstile.

5.2 Përdorimi i emrave të përcaktuar në pikën 19 rezervohet për fibrat tekstile, natyra e të cilave i korrespondon përshkrimit të përcaktuar në këtë pikë.

Emrat e përcaktuar në pikën 19 nuk përdoren për fibra të tjera, qoftë më vete, si rrënjë apo mbiemër.

Termi “mëndafsh” nuk përdoret për të treguar formën apo një pamje të caktuar në fijet filament të fibrave tekstile.

6. Produktet e pastra/të papërziera tekstile

6.1. Vetëm produktet tekstile që përbëhen ekskluzivisht nga e njëjta fibër mund të mbajnë etiketën apo markimin “100%”, “i pastër” ose “e gjitha”.

Këta terma ose të ngjashëm me ta nuk përdoren për produkte të tjera tekstile.

6.2 Pa rënë ndesh me nënpikën 7.3, një produkt tekstil që nuk përmban më shumë se 2% të peshës fibra

të huaja, gjithashtu, mund të trajtohet / konsiderohet si i përbërë ekskluzivisht nga e njëjta fibrë, me kusht që kjo sasi të jetë e argumentuar, si teknikisht e pashmangshme në praktikat e mira të prodhimit dhe të mos jetë shtuar thjesht për rutinë.

Një produkt tekstili, i cili i është nënshtruar procesit të krehjes së zakonshme, mund të trajtohet, gjithashtu, si ekskluzivisht i përbërë nga e njëjta fibrë, nëse përmban jo më shumë se 5% të peshës së tij fibra të huaja, me kusht që kjo sasi të jetë e argumentuar, si teknikisht e pashmangshme në praktikat e mira të prodhimit dhe të mos jetë shtuar thjesht si çështje rutine.

7. Produktet e leshit të bagëtisë ose leshit të pastër

7.1 Një produkt tekstili mund të etiketohet ose të markohet me emrin “lesh i pastër”, me kusht që të përbëhet ekskluzivisht nga një fibrë leshi, e cila nuk ka qenë më parë e përfshirë në një produkt të përfunduar, që nuk i është nënshtruar proceseve të tjerres dhe/ose dërstilimit, përveç atyre që kërko-hen në prodhimin e atij produkti dhe që nuk është dëmtuar nga trajtimi apo përdorimi.

7.2 Përjashtimisht nga nënpika 7.1, emri i referuar në pikën 7.1 mund të përdoret për të përshkruar përmbajtjen e leshit që gjendet në përzierjen e fibrave tekstile, në rast të plotësimit të të gjitha kushteve të mëposhtme:

- a) i gjithë leshi që është në përbërje të përzierjes plotëson kushtet e përcaktuara në nënpikën 7.1;
- b) leshi përbën jo më pak se 25% të totalit të peshës së përzierjes;
- c) në rastin e një përzierje në gjendje fibre, leshi është i përzierë vetëm me një fibrë tjetër.

Tregimi i përbërjes së përqindjes së plotë të kësaj përzierjeje është i detyrueshëm.

7.3 Fibrat e huaja në produktet e referuara në nënpikat 7.1 dhe 7.2, duke përfshirë produktet e leshit që u janë nënshtruar procesit të krehjes, nuk duhet të kalojnë 0.3% të peshës, justifikohen si teknikisht të pashmangshme në praktikat e mira të prodhimit dhe që nuk shtohen thjesht për çështje rutine.

8. Produkte tekstili me shumë fibra

8.1 Produkti i tekstilit etiketohet ose markohet me emrin dhe përqindjen sipas peshës së të gjitha fibrave përbërëse, në rend zbritës.

8.2 Përjashtimisht nga nënpika 8.1 dhe pa rënë ndesh me nënpikën 6.2, një fibrë që zë deri në 5% të totalit të peshës së produktit tekstil apo fibrat që bashkërisht zënë deri 15% të totalit të peshës së produktit tekstil, në rastet kur ato nuk mund të përcaktohen lehtësisht në momentin e prodhimit, mund të përcaktohet me anë të termit “fibra të tjera”, të shoqëruara menjëherë nga totali i përqindjes, sipas peshës.

8.3 Produktet që kanë fije të bazës pambuk të pastër dhe fije të indit lin të pastër, ku përqindja e fijeve të linit përbën së paku 40% të peshës totale të pëlhurës së pa kollarisur, mund të marrin emrin “bashkim i pambukut me linin”, që duhet të shoqërohet me specifikimin e përbërjes “fije të bazës pambuk i pastër – fije të indit lin i pastër”.

8.4 Pa rënë ndesh me nënpikën 5.1, për produktet tekstile, përbërja e të cilave është vështirë të përcaktohet në momentin e prodhimit të tyre, në etiketë ose markim mund të përdoret termi “fibra të përziera” apo termi “përbërje tekstile e paspeci-fikuar”.

8.5 Duke u shmangur nga nënpika 8.1, fibrat që ende nuk janë pjesë e listës së pikës 19, mund të përcaktohen me termin “fibra të tjera”, duke u shoqëruar menjëherë me përqindjen e tyre në total, sipas peshës.

9. Fibra dekorative dhe fibra me efekt antistatik

9.1 Fibrat e dukshme, të veçueshme që janë tërësisht dhe vetëm dekorative dhe që nuk e kalojnë 7% të peshës së produktit të përfunduar nuk duhet të merren në konsideratë në përbërjet e fibrave, të përcaktuara në pikat 6 dhe 8.

9.2 Fibrat metalike dhe fibrat e tjera që janë të përfshira për të siguruar një efekt antistatik dhe që nuk e kalojnë 2% të peshës së produktit të përfunduar nuk merren në konsideratë në përbërjet e fibrave të përcaktuara për qëllime të pikave 6 dhe 8.

9.3 Në rastin e produkteve të referuara në nënpikën 8.4, përqindjet e përcaktuara në nënpikat 9.1 dhe 9.2 llogariten veçmas mbi peshën e fijeve të bazës dhe veçmas mbi ato të indit.

10. Produkte tekstile me disa komponentë

10.1 Çdo produkt tekstili që ka në përbërjen e vet dy apo më shumë komponentë tekstili, të cilët kanë përmbajtje të ndryshme fibrash tekstile, do të ketë një etiketë ose markim ku të përcaktohet përmbajtja e fibrës tekstile të çdo komponenti.

10.2 Etiketimi ose markimi i referuar në nënpikën 10.1 nuk është i detyrueshëm për komponentë tekstile, në rastin kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- a) këto komponentë nuk janë astarë kryesore; dhe

b) këto komponentë përfaqësojnë më pak se 30% të peshës totale të produktit tekstil.

10.3 Në rastet kur dy apo më shumë produkte tekstile kanë të njëjtën përmbajtje fibrash dhe zakonisht formojnë një njësi të vetme ato mund të mbajnë vetëm një etiketë ose markim.

11. Produktet e tekstit që përmbajnë pjesë jo tekstile me origjinë shtazore

11.1 Prania e pjesëve jotekstile me origjinë shtazore në produktet tekstile tregohet përmes përdorimit të frazës: “Përmban pjesë jotekstile me origjinë shtazore”, në etiketën ose markimin e produkteve që kanë të tilla pjesë, sa herë që ato bëhen të disponueshëm në treg.

11.2 Etiketimi ose markimi nuk duhet të jetë çorientues dhe duhet të jepet në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i kuptueshëm nga konsumatori.

12. Etiketat dhe markimet

12.1 Produktet tekstile etiketohen dhe markohen në mënyrë të tillë që të tregohet përbërja e fibrave të tyre, sa herë që ato bëhen të disponueshëm në treg.

Etiketimi dhe markimi i produkteve tekstile duhet të jetë i qëndrueshëm, lehtësisht i lexueshëm dhe i aksesueshëm dhe në rastin e etiketës, të jetë e bashkengjitur mirë.

12.2 Pa rënë ndesh me nënplikën 12.1, etiketa ose markimi mund të zëvendësohen ose të plotësohen me dokumentet tregtare shoqëruese, kur produktet u furnizohen operatorëve ekonomikë brenda zinxhirit të furnizimit, ose kur ata janë si përgjigje për një porosi nga një autoritet kontraktual.

12.3 Emrat e fibrave tekstile dhe përshkrimet e përbërjeve të fibrave të referuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8 duhet të bëhen të qarta në dokumentet shoqëruese tregtare, të cilave u referohet nënplika 12.2.

Nuk përdoren shkurtime, me përjashtim të një kodi të mekanizuar përpunimi, ose kur këto shkurtime janë të përcaktuara në standardet ndërkombëtare, me kusht që të jenë të shpjeguara në të njëjtin dokument tregtar.

13. Detyrimi për vendosjen e etiketës apo markimit

13.1 Kur një produkt tekstili behet i disponueshëm në treg, prodhuesi garanton vendosjen e etiketës ose markimit dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë ato. Në rastet kur prodhuesi nuk është i vendosur në Shqipëri, importuesi garanton vendosjen e etiketës ose markimit dhe saktësinë e informacionit të tyre.

13.2 Për qëllimet e këtij Rregulli Teknik, shpërndarësi konsiderohet si një prodhues kur ai bën të disponueshëm një produkt në treg në emrin apo markën e vet, vendos vetë etiketën apo modifikon përmbajtjen e etiketës.

13.3 Kur një produkt tekstili bëhet i disponueshëm në treg, shpërndarësi siguron që produktet tekstile mbartin etiketimin ose markimin e duhur të përcaktuar në këtë Rregull Teknik.

13.4 Operatorët ekonomikë të referuar në nënplikat 13.1, 13.2 dhe 13.3, garantojnë që çdo informacion që jepet kur produktet tekstile bëhen të disponueshëm në treg, nuk mund të ngatërrohet me emrat e fibrave tekstile dhe përshkrimet e përbërjeve të fibrave, sipas këtij Rregulli Teknik.

14. Përdorimi i emrave të fibrave tekstile dhe përshkrimeve të përbërjes së fibrave

14.1 Kur një produkt tekstili bëhet i disponueshëm në treg, përshkrimet e përbërjes së fibrave tekstile, të referuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8 jepen në katalogët dhe literaturën tregtare, mbi paketimin, etiketat dhe markimet në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të lexueshme, të qarta, të dukshme dhe me germa uniforme, për sa i takon madhësisë, stilit dhe llojit të germës së përdorur. Informacioni duhet të jetë qartësisht i dukshëm për konsumatorin, përpara blerjes, duke përfshirë edhe rastet kur blerja bëhet me anë të mjeteve elektronike.

14.2 Markat tregtare ose emri i sipërmarrjes mund të vihen menjëherë përpara ose pas përshkrimeve të përbërjes së fibrave tekstile, të referuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8.

Megjithatë, në rastet kur një markë tregtare ose emri i një sipërmarrjeje përmban, më vete apo si rrënjë apo si mbiemër, njërin nga emrat e fibrave tekstile të dhënë në pikën 20 apo një emër që ka gjasa të ngatërrohet me to, kjo markë apo ky emër vihet menjëherë përpara ose pas përshkrimeve të përbërjes së fibrave tekstile, të referuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8.

Informacione të tjera jepen gjithmonë veçmas.

14.3 Etiketimi ose markimi sigurohet në gjuhën shqipe.

Në rastin e fijeve që përdoren për qepje, qëndisje dhe riparime të bobinave, çikrikëve, torkave, topave/(shtëllunge fjongoje) apo sasive të tjera të vogla të qepjeve, aplikohet nënparagrafi i parë për etiketimin gjithëpërfshirës të referuar në nënplikën 15.3. Në rastet kur këto produkte shiten në mënyrë individuale, ato mund të etiketohen apo markohen në cilëndo prej gjuhëve zyrtare të institucioneve të BE-së, me kusht që ato të jenë paisur me etiketim gjithëpërfshirës.

15. Përjashtime

15.1 Rregullat e dhëna në pikat 10, 12, 13 dhe 14 janë subjekt i përjashtimeve të nënplikave 15.2, 15.3 dhe 15.4.

15.2 Nuk kërkohet tregimi i emrave të fibrave tekstile apo përbërjes së fibrave në etiketat dhe markimet e produkteve tekstile, të listuara në pikën 21.

Megjithatë, në rastet kur marka ose emri i një sipërmarrjeje përmban, më vete apo si pjesë e rrënjës, ose një mbiemër njërin prej emrave të listuar në pikën 19 ose një emër që ka gjasa të ngatërrohet me to zbatohen pikat 10, 12, 13 dhe 14.

15.3 Në rastet kur produktet tekstile të listuara në pikën 22 janë të të njëjtit lloj dhe përbërjeje të fibrave, ato mund të bëhen të disponueshme në treg së bashku me një etiketim gjithëpërfshirës.

15.4 Përbërja e fibrave të produkteve tekstile që shiten me metër mund të jepet te gjatësia apo topi i metrazhit që bëhet i disponueshëm në treg.

15.5 Produktet tekstile, të cilat referohen në nënpikat 15.3 dhe 15.4, bëhen të disponueshëm në treg në mënyrë të tillë që përbërja e fibrave të atyre produkteve t'u bëhet e ditur çdo blerësi në zinxhirin e furnizimit, duke përfshirë konsumatorin.

KAPITULLI 3 MBIKËQYRJA E TREGUT

16. Kontrollat e mbikëqyrjes së tregut

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut nën ministrinë përgjegjëse për tregtinë (më poshtë struktura përgjegjëse) kryen kontrole mbi përputhshmërinë e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile me informacionin e dhënë lidhur me përbërjen e fibrave të atyre produkteve sipas kërkesave të këtij Rregulli Teknik.

17. Përcaktimi i përbërjes së fibrave

17.1 Me qëllim të përcaktimit të përbërjes së fibrave të produkteve tekstile, kontrollat të cilave u referohet pika 16 kryhen në përputhje me metodat e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për tregtinë ose me standardet e harmonizuara shqiptare të referuara në këtë udhëzim.

17.2 Në përcaktimin e përbërjes së fibrave të përcaktuara në pikat 6, 7 dhe 8, nuk merren në konsideratë artikujt e listuar në pikën 23.

17.3 Përbërja e fibrave të përcaktuara në pikat 6, 7 dhe 8, përcaktohet nëpërmjet zbatimit të masës anhidroze për secilën fibrë, tolerancën e përshtatshme të lejuar të dhënë në pikën 24, pas largimit të artikujve që përcaktohen në pikën 23.

17.4 Laboratorët përgjegjës, për testimin e përzierjeve tekstile për të cilat nuk ka metodë uniforme të analizave në nivel evropian, përçaktojnë përbërjen e fibrave të këtyre përzierjeve, duke përcaktuar në raportin e analizave rezultatet e përfutura, metodologjinë e përdorur dhe shkallën e saktësisë.

18. Tolerancat

18.1 Për qëllime të përcaktimit të përbërjes së fibrave të produkteve tekstile zbatohen tolerancat e përcaktuara në nënpikat 18.2, 18.3 dhe 18.4.

18.2 Pa anashkaluar nënpikën 7.3, prania e fibrave të huaja në përbërjen e fibrave sipas pikës 8 nuk ka nevojë të tregohet, në rast se përqindja e këtyre fibrave nuk arrin vlerat e mëposhtme:

a) 2% të peshës totale të produktit tekstil, me kusht që kjo të jetë e justifikuar si teknikisht e pashmangshme, sipas praktikave të mira të prodhimit dhe të mos shtohet thjesht për inerci / rutine; ose

b) 5% e peshës totale në rastin e produkteve tekstile, të cilat i janë nënshtruar procesit të krehjes, me kusht që kjo sasi të jetë e justifikuar si teknikisht e pashmangshme, sipas praktikave të mira të prodhimit dhe të mos shtohet për inerci/si rutinë.

18.3. Një tolerancë prodhimi prej 3% lejohet midis përbërjes së deklaruar të fibrave, që jepet në përputhje me pikën 8 dhe përqindjeve të përfutura nga analizat e kryera në përputhje me pikën 17, në lidhje me peshën totale të fibrave që jepen në etiketë apo markim. Kjo tolerancë zbatohet edhe për sa më poshtë vijon:

a) fibrat të cilat mund të përcaktohen me termin “fibra të tjera” në përputhje me pikën 8;

b) përqindja e leshit të referuar në nënpikën 7.2/b.

Për qëllime të analizave, tolerancat llogariten veçmas. Pështja totale që merret në konsideratë gjatë llogaritjes së tolerancës të referuar në këtë paragraf është ajo e fibrave të produktit të përfunduar, duke zbritur peshën e çdo fibre të huaj të gjetur gjatë zbatimit të tolerancës së referuar në nënpikën 18.2.

18.4 Aplikimi kumulativ i tolerancave të referuara në nënpikat 18.2 dhe 18.3 lejohet vetëm në rast se ndonjë prej fibrave të huaja të gjetura nga analiza, gjatë zbatimit të tolerancës së referuar në nënpikën 18.2, provojnë të jenë nga i njëjti lloj kimik, si një apo më shumë prej fibrave që tregohen në etiketë apo markim.

18.5 Në rastin e produkteve të veçanta tekstile për të cilat procesi i prodhimit kërkon toleranca më të larta nga ato që janë parashtruar në nënpikat 18.2 dhe 18.3, ministri përgjegjës për tregtinë mund të autorizojë toleranca më të mëdha/larta.

Përpara bërjes së disponueshme të produktit tekstil në treg, prodhuesi paraqet një kërkesë për autorizim pranë ministrit përgjegjës për tregtinë, duke parashtruar argumente të mjaftueshme dhe prova për rrethanat e veçanta të prodhimit. Autorizimi mund të jepet vetëm në rrethana të veçanta përjashtimore dhe kur prodhuesi ka argumente të përshtatshme për një gjë të tillë.

Në rast se konsiderohet me vend, ministri miraton kritere teknike dhe rregulla procedurore për zbatimin e kësaj nënpike.

19. Lista e emrave të fibrave tekstile (të referuara në pikën 5)

Tabela 1

Numri	Emërtimi	Përshkrimi i fibrave
1	Lesh	Fibra nga qethja e deles ose qengjit (<i>Ovis aries</i>) ose përzierja e fibrave nga qethja e deles ose qengjit me qimet e kafshëve të renditura në numrin 2
2	alpaka, lama, gamile, kashmir, mohair, angora vikunja, jak, guanako, kashgora,, kastori, vidra, ku përpara mund të vihet ose jo fjala “lesh” ose “qime”	Qimet e kafshëve të mëposhtme: alpaka (e ngjashme me lamën), lama, gamile/deve, dhia Kashmir, dhia angora, lepurit angora, vikunja (deve e egër e Amerikës Jugore), jaku (kafshë në Himalaja), guanaco (deve e Amerikës së Jugut 1-1,2 m), dhia kashgora (kryqëzim i dhisë angora me dhinë kashmir), kastori, vidra
3	Qimet e kafshëve dhe të kuajve, me ose pa dhënë llojin e kafshës (p.sh., qimet e gjedhëve, qimet e dhive të zakonshme, qimet e jeleve të kuajve)	Qimet e kafshëve të ndryshme që nuk përmenden në pikën 1 ose 2
4	Mëndafsh	Fibra e marrë vetëm nga insektet që sekretojnë mëndafsh
5	Pambuk	Fibra që merren nga boçet e bimësisë së pambukut (<i>Gossypium</i>)
6	Kapok	Fibra e marrë nga pjesa e brendshme e frytit të kapokut (<i>Ceiba pentdhera</i>)
7	Liri (ose lino)	Fibra e marrë nga kërcelli i bimësisë së lirit (<i>Linum usitatissimum</i>)
8	Kërpi i vërtetë	Fibra e marrë nga kërcelli i kërpit (<i>Cannabis sativa</i>)
9	Juta	Fibra e marrë nga kërcelli i <i>Corchorus olitorius</i> dhe <i>Corchorus capsularis</i> . Për qëllimet e këtij Rregulli Teknik, fibrat kërcellore të marra nga speciet e mëposhtme duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si edhe juta: <i>Hibiscus cannabinus</i> , <i>Hibiscus sabdariffa</i> , <i>Abutilon avicennae</i> , <i>Urena lobata</i> , <i>Urena sinuata</i>
10	Abaka (kërpi i Manilës)	Fibra e marrë nga gjethet veshëse të <i>Musa textilis</i>
11	Alfa	Fibrat e marra nga gjethet e <i>Stipa tenacissima</i>
12	coir (arra e kokosit)	Fibra e marrë nga fryti i <i>Cocos nucifera</i>
13	Gjineshtra	Fibra e marrë nga kërcelli i <i>Cytisus scoparius</i> dhe/ose <i>Spartium junceum</i>
14	Ramie	Fibra e marrë nga kërcelli i <i>Boehmeria nivea</i> dhe <i>Boehmeria tenacissima</i>
15	Sizali	Fibra e marrë nga gjethet e <i>Agave sisalana</i>
16	Sunn	Fibra nga kërcelli i <i>Crotalaria juncea</i>
17	Henequen	Fibra nga kërcelli i <i>Agave fourcroydes</i>
18	Maguey	Fibra nga kërcelli i <i>Agave cantala</i>

Tabela 2

Numri	Emri	Përshkrimi i fibrës
19		Fibra të acetatit të celulozës në të cilën janë të acetiluara më pak se 92%, por jo më pak se 74% e grupeve hidroksil
20	Alginat	Fibra e marrë nga kripërat e metaleve nga acidi alginik
21	Kupro	Fibra nga celuloza e rigjeneruar, të përfutuara nga procesi kuproamoniakal
22	Modal	Një fibër nga celuloza e rigjeneruar e marrë nga procesi i modifikimit të viskozës që ka module të mëdha në forcën këputëse dhe në gjendje të njomë. Forca këputëse (FK) në gjendje të kushtëzuar dhe forca (MK) që kërkohet për të dhënë një zgjatim prej 5% në gjendje të njomë janë: $FK(cN) \geq 1,3 \sqrt{T + 2T}$ $MK(cN) \geq 0,5 \sqrt{T}$

		Ku T është densiteti mesatar linear i shprehur në decitëks
23	Protein	Fibër e marrë nga substanca me proteinë natyrale e rigjeneruar dhe e stabilizuar nëpërmjet veprimit të agjentëve kimikë
24	Triacetate	Fibër e acetatit të celulozës në të cilën janë acetiluar të paktën 92% e grupeve hidroksil
25	Viskozë	Fibra të celulozës së rigjeneruar të përfutuara nga procesi i viskozës për marrjen e filamenteve dhe fibrave të prera
26	Akrilik	Fibra të formuara nga makromolekula lineare që përmbajnë të paktën 85% (në masë) grupe akrilonitrile në varg
27	Klorofibër	Fibra të formuara nga makromolekula lineare që kanë në vargun e tyre më shumë se 50% në masë njësi monomeresh të vinilit të kloruar ose vinilidenit të kloruar
28	Fluorofibër	Fibra të formuara nga makromolekula lineare të prodhuara nga monomeret alifatike të fluorokarbonit
29	Modakrilik	Fibra të formuara nga makromolekula që kanë në vargun e tyre më shumë se 50% dhe më pak se 85% (në masë) të grupeve akrilonitrile
30	Poliamide ose najlon	Fibrat e formuara nga makromolekulat sintetike lineare që kanë në vargun e tyre lidhje amide të paktën 85% e të cilave bashkohen me njësitë alifatike dhe cikloalifatike
31	Aramide	Fibra të formuara nga makromolekulat sintetike lineare të ndërtuara nga grupe aromatike të bashkuara me lidhje amide ose imide, nga të cilat të paktën 85% janë të lidhura direkt me dy unaza aromatike dhe me një numër lidhjesh imide, të cilat nëse janë prezente nuk e kalojnë numrin e lidhjeve amide
32	Polimide	Fibra të formuara nga makromolekula sintetike lineare që kanë në vargun e tyre njësi imide periodike
33	Lyocell	Një fibër e celulozës së rigjeneruare përfutur me tretje, dhe një proces tjerjeje me një tretës organik (përzierje e reagentëve kimikë organikë në ujë), pa formim derivativesh
34	Polilactide	Fibra të formuara nga makromolekula lineare që kanë në varg të paktën 85% (në masë) njësi estere të acidit laktik të marrë nga sheqerna që hasen në natyrë, dhe të cilët kanë një temperaturë shkrirjeje të paktën 135°C
35	Polyester	Fibra të formuara nga makromolekula lineare që përmbajnë të paktën 85% (në masë) në vargun e tyre një ester të acidit diol dhe tereftalik
36	Polietileni	Fibra të formuara nga makromolekula lineare të saturuara me hidrokarbon të alifatikëve të pa zëvendësuar
37	Polipropilen	Fibra të formuara nga një makromolekulë lineare me hidrokarbon të alifatikëve të pazëvendësuar ku një në çdo dy atome karboni bart një varg anësor metil me natyrë izostatike dhe pa zëvendësime të mëtejshme
38	Polikarbamide	Fibra të formuara nga makromolekula lineare që kanë në varg grup funksional të ureylene periodike (NH-CO-NH)
39	Poliuretan	Fibra të formuara nga makromolekula lineare të përbëra nga grupe funksionale periodike të uretanit
40	Vinilal	Fibra të formuara nga makromolekula lineare vargu i të cilave përbëhet nga poli (vinil alkooli) me nivele të ndryshëm acetilimi
41	Trivinil	Fibra të formuara nga terpolimeri i akrilonitrilit, një monomer i vinilit kloruar dhe një monomer i tretë i vinilit, ku asnjë prej të cilëve nuk përfaqëson më shumë se 50% të masës totale
42	Elastodiene	Fibra elasto e përbërë nga poli-isopreni natyral ose sintetik, ose e përbërë nga një ose më shumë diene të polimerizuara me ose pa një ose më shumë monomere vinili, dhe të cilët, kur zgjaten deri në tre herë të gjatësisë së saj fillestare dhe çlodhet, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare
43	Elastin	Elastofibër e përbërë nga një poliuretan i segmentuar të paktën 85% (në masë) dhe e cila, kur zgjatet deri në tri herë të gjatësisë së saj fillestare dhe çlodhet, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare
44	Fibra qelqi	Fibra të prodhuara nga qelqi
45	elastomultiester	Fibra të formuara nga ndërveprimi i dy ose më shumë makromolekulave lineare të dallueshme nga pikëpamja kimike në dy ose më shumë faza të dallueshme (nga të cilat asnjëra nuk tejkalon 85% në masë) që përmban grupe estere si një njësi mbizotëruese funksionale (të paktën 85%) dhe që, pas një trajtimi të përshtatshëm

		kur zgjaten 1.5 herë të gjatësisë fillestare dhe çlodhet, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare
46	Elastolefin	Fibra të formuara nga makromolekula pjesërisht me lidhje të tërthorta të paktën 95% (në masë), të prodhuara nga etileni dhe të paktën një elefinë tjetër dhe që, kur zgjaten 1.5 herë të gjatësisë fillestare dhe çlodhen, rikthehen në mënyrë të shpejtë dhe të qenësishme në gjatësinë e tyre fillestare
47	Melamina	Fibra të formuara në të paktën 85% në masë të tyre nga makromolekula me lidhje të tërthorta të prodhuara nga derivate të melaminës
48	Emra që i korrespondojnë materialit nga i cili janë formuar fibrat, p.sh., nga metale (metalike, të metalizuara), azbesti, letra, e pasuar ose jo nga fjala “fill” ose “fibër”	Fibrat e marra nga materiale të ndryshëm ose të cilët nuk janë renditur më sipër.

20. Kërkesa të veçanta për etiketimin dhe markimin e disa produkteve tekstile

Përbërja e fibrave të produkteve tekstile, të listuara në këtë pikë, tregohen në përputhje me dispozitat për etiketimin dhe markimin, të përcaktuara në këtë pikë.

Produktet	Kërkesa për etiketimin dhe markimin
1. Produktet e mëposhtme të korseterisë:	Përbërja e fibrave jepet në etiketë dhe markim duke deklaruar përbërjen e të gjithë produktit ose si pjesë përbërëse apo veçmas, atë të komponentëve secili më vete:
a) Gjoksore	Pjesa e jashtme dhe e brendshme e sipërfaqes së kupave dhe kurrizit
b) Korse dhe breza	Përpara, pas, anash
c) Korse	Pjesa e brendshme dhe e jashtme e sipërfaqes së formave, pjesët ballore dhe të pasme dhe pjesët anësore.
2. Produkte korseterie që nuk përmenden më lart	Përbërja e fibrës jepet përmes deklarimit të përbërjes së të gjithë produktit, veçmas apo bashkërisht i komponentëve të ndryshëm të produktit. Ky etiketim nuk është i detyrueshëm për komponentë që përfaqësojnë më pak se 10% të peshës totale të produktit.
3. Të gjitha produktet e korseterisë	Etiketimin dhe markimin veçmas i pjesëve të ndryshme të produkteve të korseterisë bëhet në mënyrë të tillë që konsumatori të kuptojë me lehtësi së cilës pjesë së produktit i referohet informacioni në etiketë ose në markim
4. Tekstile të gdhendura me shtypje	Përbërja e fibrave jepet për produktin si i tërë dhe mund të jepet përmes deklarimit veçmas të përbërjes së pëlhurës bazë dhe atë të pjesëve të qepura. Këta komponentë përmenden me emër
5. Tekstile të qëndisura	Përbërja e fibrave jepet për produktin si i tërë dhe mund të jepet duke deklaruar veçmas përbërjen e pëlhurës bazë dhe atë të fillit të qëndisjes. Këta komponentë përmenden me emër. Ky lloj etiketimi apo markimi është i detyrueshëm vetëm për pjesët e qëndisura të cilat arrijnë të paktën 10% të sipërfaqes së produktit
6. Fije që konsistojnë në fije të produktit bazë të tekstilit dhe fije të një produkti tjetër tekstili që vihet mbi të parin, që përbëhen nga fibra të ndryshme tekstili dhe bëhen të disponueshme si të tilla te konsumatori	Përbërja e fibrave jepet për produktin në tërësi dhe mund të jepet duke dhënë veçmas përbërjen e bërthamës dhe mbulesës. Këta komponentë mund të përmenden me emër
7. Tekstile kadiçe dhe plush ose tekstile të ngjashme me kadifen ose plushin	Përbërja e fibrave jepet për të gjithë produktin në tërësi dhe mund të tregohet veçmas përbërja e produktit bazë të tekstilit dhe e produktit tjetër që vihet mbi të. Këta komponentë përmenden me emër
8. Mbulesa dyshemesh dhe qilima të cilat përbëhen nga fibra të ndryshme tekstili në pjesën e përdorshme të poshtme dhe të sipërme	Përbërja e fibrave mund të jepet vetëm për sipërfaqen e sipërme (që përdoret). Sipërfaqja e përdorur përmendet me emër.

21. Produkte tekstile për të cilat etiketimi ose markimi nuk është i detyrueshëm (referuar në nënpikën 15.2)

1. Shirit/këllëfë mbështetës të krahëve;
2. Rripa orësh prej materialeve tekstile;
3. Etiketa dhe distinktiva (shenja dalluese);
4. Kapëse me material me mbushje tekstile për enët e kuzhinës;
5. Mbështjellëse komode tekstili për enët e kafesë;
6. Mbështjellëse komode tekstili për enët e çajit;
7. Mëngë mbrojtëse për duart;
8. Gëzofë për duar përveç atyre me thekë;

9. Lule artificiale;

10. Jastëkë për të mbajtur gjilpërat;

11. Kanavacë e pikturuar;

12. Produkte tekstile për pëlhurat bazë dhe ato nën të, si dhe për ngjitje apo forcim të pëlhurave;

13. Produkte të vjetra tekstile ku deklarohet se janë të tilla;

14. Mbrojtëse këmbësh;

15. Ambalazhe/paketime jo të reja dhe të shitura si të tilla;

16. Produkte zbukurimi dhe takëme kuajsh prej produkte tekstili;

17. Mallra udhëtimi prej produkte tekstili;

18. Tapiceri të qëndisura me dorë, të përfunduara ose jo dhe materialet për prodhimin e tyre, duke përfshirë fillin për qëndisje, të shitur veçmas nga kanavaca dhe të paraqitura enkas për përdorim në të tilla tapiceri;

19. Shtrënguese për veshje/zinxhirë;

20. Butona dhe kopsa të mbuluara me material tekstili;

21. Mbulesa libri prej materialeve tekstili;

22. Lodra;

23. Pjesë tekstile për këpucë;

24. Mbulesa tavoline që kanë komponentë dhe një sipërfaqe jo më të madhe se 500cm²;

25. Doreza/ veshje për furra;

26. Mbështjellëse/mbulesa për vezë;

27. Kutitrukim;

28. Qesë duhani prej pëlhure tekstili;

29. Kutitpikturash, të purove, cigareve, çakmakësh, krehri të bëra me pëlhura tekstili;

30. Mbështjellëse/mbulesa për telefona celularë dhe për mjete të tjera të lëvizshme me një sipërfaqe më të madhe se 160 cm²;

31. Pajisje mbrojtëse me përdorime në sport me përjashtim të dorezave;

32. Kutitualeti;

33. Kutipër pastrim këpucësh;

34. Produkte funerali;

35. Produkte të disponueshme me përjashtim të vatës,

36. Produktet tekstile subjekt i kërkesave të Farmakopës Evropiane, si fashë me shumë përdorime për qëllime mjekësore dhe ortopedike dhe produkte tekstili ortopedike në përgjithësi.

37. Produkte tekstile, duke përfshirë: litarë dhe kordonë, subjekt i nënpikës 12 të pikës 22, që zakonisht përdoren:

a) për përdorim si komponent për pajisjet në manifakturë dhe përpunimin e mallrave;

b) për t'u përfshirë në makineri, instalime (p.sh. për ngrohje, ajër të kondicionuar apo ndriçim), në pajisje shtëpiake dhe të tjera, mjete të tjera transporti, ose për vënien e tyre në funksionim, për mirëmbajtjen, përveç mbulesave të gomuara dhe aksesorëve tekstilë të pajisjeve motorike, që shiten veçmas nga makina;

38. Produkte tekstile për qëllime mbrojtjeje dhe sigurie, si p.sh. rripa sigurimi, parashuta, jelek shpëtimi, kalime emergjente, pajisje për zjarrfikësit, jelek antiplumb dhe veshje të tjera të posaçme mbrojtëse (si p.sh. kundërzjarrit, substancave kimike ose rreziqeve të tjera të sigurisë);

39. Struktura mbështetëse me ajër (si p.sh. holle sportive, stenda ekspozimi/ekspozitorë, objekte magazinimi), me kusht që të jenë dhënë detaje të performancës dhe specifikimet teknike për to;

40. Vela;

41. Veshje për kafshët;

42. Flamuj dhe banderola.

22. Produkte tekstile për të cilat etiketimi gjithëpërfshirës është i mjaftueshëm (referuar në nënpikën 15.3)

1. Lecka për dyshe-menë;

2. Lecka pastrimi;

3. Shirita dhe ornamente/stoli;

4. Tekstile zbukurimi;

5. Rripa;

6. Tiranda;

7. Tiranda, zhartierë;

8. Lidhëse këpucësh dhe çizmesh;

9. Fjongo;
 10. Llastik;
 11. Paketime të reja të shitura si të tilla;
 12. Spango paketimi dhe spango për qëllime bujqësore; kordonë, spango dhe lidhëse, të ndryshme nga ato që janë pjesë e nënpikës 37 të pikës 21(1);
 13. Mbulesa tavolinash;
 14. Shami dore;
 15. Rrjeta për flokët topuz dhe rrjeta flokësh;
 16. Fjongo dhe kordele të ndryshme për fëmijë;
 17. Grykore, dorashka për të larë trupin, dorashka për të larë fytyrën;
 18. Lloje të ndryshme fijesh për qepje, riparime, qëndisje për shitje me pakicë në sasi të vogla, me peshë neto më pak se 1 gram ose më pak;
 19. Kordele shirita për perde dhe grila;
- (1) Për produktet që bëjnë pjesë në këtë artikull dhe që shiten me copa, etiketimi i brendshëm do të jetë pjesë e topit. Litarët dhe rripat që janë pjesë e këtij artikulli përfshijnë ata që përdoren për sporte malore dhe ujore.

23. Artikuj që nuk merren në konsideratë për përcaktimin e përbërjes së fibrave (referuar në nënpikën 17.2)

Produktet	Artikuj të përjashtuar
a) Të gjitha produktet tekstile	i) Pjesë jotekstile, bordura, etiketa dhe shenja, zbukurime dhe stoli që nuk përbëjnë një pjesë integrale të produktit, butona dhe kopsa të mbuluara me materiale tekstili, aksesore, zbukurime, shirita joelastikë, fije elastike përthurje të shtuara në pika të veçanta të produktit dhe subjekt i kushteve të specifikuara në pikën 9, fibra të dukshme izolative, të cilat janë vetëm dekorative dhe fibra me efekt antistatik, ii) Substanca yndyrore, lidhës, peshues, matës dhe veshës, produkte ngopës, produkte shtesë ngjyrosës dhe printimi, produkte të tjera tekstili të procesit të përpunimit.
b) Mbulesa për dysheme dhe qilima	Të gjithë komponentët të ndryshëm nga ato me përdorim në sipërfaqe.
c) Pëlhura tapicerie	Lidhës dhe mbushës të bazës dhe indit të cilat nuk janë pjesë të sipërfaqes së përdorur.
d) Perde	Lidhës dhe mbushës të bazës dhe indit të cilët nuk janë pjesë e faqes së përparme të pëlhurës.
e) Çorapë	Fije shtesë elastike të përdorura si përforësues në pjesën e përparme dhe në thembra
dh) Geta	Fije shtesë elastike të përdorura si përforësues në pjesën e përparme dhe në thembra
e) Produkte tekstile të ndryshme nga ato që janë në pikat nga (b) deri në (dh)	Baza ose pëlhura themelore, përforcime, kanavaca, qepje dhe montime nëse ato zëvendësojnë bazën brendshme Për qëllime të kësaj kërkesë: i) baza ose materiali kryesor i produkteve tekstile, të cilët shërbejnë si një mbështetje për sipërfaqen e përdorur, veçanërisht në batanije dhe pëlhura dyshe, kadife dhe produkte të afërta me to nuk konsiderohen si ana e prapme që lëviz; ii) “përforësues” është filli ose materiali i shtuar në pika të limituara dhe specifike të produkteve tekstile për të forcuar ato ose për t’i dhënë atyre shtangësi ose trashësi.

24. Toleranca e lejuar që përdoret për llogaritjen e masës së fibrave që gjenden në një produkt tekstili

(referuar në nënpikën 17.3)

Fibra nr.	Fibrat	Përqindjet
1-2	Lesh dhe qime kafshësh:	
	fibra me krehje të zakonshme	18,25
	fibra me krehje jo të zakonshme	17,00 (1)
3	Qime kafshësh:	
	fibra me krehje të zakonshme	18,25
	fibra jo me krehje të zakonshme	17,00 (1)
	Jele kuajsh:	
	fibra me krehje të zakonshme	16,00
	fibra me krehje të zakonshme	15,00
4	Mëndafsh	11,00

5	Pambuk:	
	fibra normal	8,50
	fibra të mercelizuara	10,50
6	Kapok	10,90
7	Lin	12,00
8	kërp	12,00
9	Juta	17,00
10	Abaka	14,00
11	Alfa	14,00
12	Fibër nga lëvorja e kokosit	13,00
13	Gjineshtër	14,00
14	Ramie (fibra të zbardhura)	8,50
15	Sisal	14,00
16	Sunn	12,00
17	Henecquen	14,00
18	Maguey	14,00
19	Acetate	9,00
20	Alginate	20,00
21	Cupro	13,00
22	Modal	13,00
23	Protein	17,00
24	Triacetate	7,00
25	Viskozë	13,00
26	Akrilik	2,00
27	Klorofibër	2,00
28	Fluorofibre	0,00
29	Modakrilik	2,00
30	Polyamide ose najlon:	
	fibër e ndërprerë	6,25
	filament	5,75
31	Aramid	8,00
32	Polyimide	3,50
33	Lyocell	13,00
34	Polylactide	1,50
35	Poliestër	1,50
36	Polietilen	1,50
37	Polipropilen	2,00
38	Polikarbamid	2,00
39	Poliuretan:	
	fibër e ndërprerë	3,50
	filament	3,00
40	Vinylal	5,00
41	Trivinyl	3,00
42	Elastodiene	1,00
43	Elastan	1,50
44	Fibra qelqi:	
	me diametër mesatar mbi 5µm	2,00
	me diametër mesatar 5 µm ose më pak	3,00
45	Elastomultiestër	1,50
46	Elastolefin	1,50
47	Melaminë	7,00
48	fibër metalike	2,00
	fibër e metalizuar	2,00
	asbest	2,00
	fill letre	13,75

1. Toleranca e lejuar prej 17.00% zbatohet, gjithashtu, dhe përshtatshme për rastet kur është e pamundur të vërtetohet nëse produkti tekstil që përmbante lesh dhe/ose qime kafshësh është me krehje të zakonshme ose jo.